

Prof. Dr. Nagip Skenderi

EKONOMIA MONETARE

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI: EKONOMIKS




- Paraja, institucionet dhe tregjet financiare rol shumë të rëndësishëm në ekonomi
- Në ekonominë e tregut të lirë hasim shumë shpesh dukuri ekonomike që nuk mund të kuptohen dhe ndikohen, nëse nuk njohim teoritë që i shpjegojnë ato

- Oferta e parasë, norma e interesit etj. ndikojnë mbi ekonominë dhe gjëndjen tonë ekonomike
- Për të kuptuar më mirë teoritë e tilla, duhet analizuar konceptet kryesore
- Objekt i lëndës së Ekonomisë Monetare:
Paraja, Bankat dhe Tregjet Financiare

Konceptet kryesore ekonomike

- Familja
- Firma
- Qeveria
- Të huajt





- **Kërkesa Agregate (AD)**

$$AD = C + I + G + Nx$$

- **Oferta Agregate (AS)**

$$AS = Y = \ddot{e} + p + r + i + d + t$$

\ddot{e}pagat (si shpërblim i faktorit punë)

pfitimet e firmave (si shpërblim i aftësisë sipërmarrëse)

inorma e interesit (si shpërblim i faktorit kapital)

rrenta (si shpërblim i faktorit tokë)

damortizimi (që i shtohet vlerës së produktit si pjesa e investimeve që zëvendësojnë konsumin e kapitalit)

ttaksat indirekte (të cilat vendosen në fazën e konsumit dhe i rrisin vlerën produktit total)

- **EkUILIBRI Makroekonomik**

$$AD = AS$$

Ose

$$AD = Y$$

Lëvizja Monetare dhe Sektori Financiar

- Lëvizja në vlerë e aktivitetit ekonomik e lidhur me sektorin financiar të ekonomisë
- Sektori financiar realizon kalimin e mjeteve monetare nga një subjekt tek tjetri
- Subjektet ekonomike kërkojnë të shpenzojnë më tepër se sa që kanë të ardhura
- Gjatë aktivitetit ekonomik midis lëvizjes monetare dhe asaj reale të ekonomisë krijohen mospërputhje

- Mospërputhjet midis kursimtarëve (huadhënësve) dhe shpenzuesve (huamarrësve)
- Kjo mospërputhje kushtëzon lëvizjen e mjeteve të lira (fondeve të luajtshme) nga ata që kursejnë tek ata që shpenzojnë (investojnë)
- Kjo lëvizje realizohet nëpërmjet financimit direkt në *tregjet financiare*, ose indirekt nëpërmjet *institucioneve financiare apo ndërmjetësve financiarë*


- *Tregu financiar përfaqëson kalimin direkt të fondeve të luajtshme nga huadhënësit te huamarrësit nëpërmjet shitblerjes së aktiveve financiare*
- Aktivet financiare janë kontrata midis huadhënësve dhe huamarrësve

Tregu Financiar

HUADHËNËSIT
HUAMARRËSIT

Familjet
Firmat

Firmat
Qeveria



S_n

E

Fondet =

Fondet =

Qeveria
Familiet

Objekti i studimit të Ekonomisë Monetare

- Midis sektorit real dhe atij financiar lidhje e ngushtë dhe ndikim reciprok
- Objekti i studimit të ekonomisë monetare:
 - *Cilat janë lidhjet midis sektorit real dhe financiar?*
 - *Cili është ndikimi i sektorit financiar mbi atë real?*
 - *Cilat janë politikat që mund të përdoren për të ndikuar në sektorin real nëpërmjet atij financiar, ose thënë ndryshe, si mund të*

- Domosdoshmëria e studimit të Ekonomisë Monetare (parasë, bankave dhe tregjeve financiare) është e qartë nëse kemi parasysh këto raporte:

- *Lidhja Para – Cikël Biznesi*
- *Lidhja Para – Inflacion*
- *Lidhja Para – Norma Interesi*
- *Hartimi dhe Zbatimi i politikës Monetare*
- *Bankat dhe Roli i Tyre*
- *Tregjet Financiare dhe Roli i Tyre*

PARAJA DHE FUNKSIONET E SAJ

- Paraja matëse e vlerave të aktiviteteve ekonomike
- Por, ajo ka dhe ndikime tjera në ekonomi
- Përmes manipulimit të parasë hartohen dhe implementohen politikat monetare
- *Me para kuptojmë gjithçka të shprehur në njësi monetare që pranohet përgjithësisht si mjet këmbimi e pagese*

● Si para mund të shërbejë çdo instrument financiar që kryen këto funksione:

- si mjet këmbimi
- si matës i vlerës dhe
- si ruajtëse e vlerës

Funksionet e parasë

- **A. Mjet Këmbimi**
- Për realizimin e këtij funksioni paraja duhet t'i plotësojë këto karakteristika fizike:
 - *Lehtësia në këmbim*
 - *Uniformiteti i paraqitjes*
 - *Qëndrueshmëria*
 - *Lehtësia në transportim*
 - *Siguria nga fallsifikimet*

- **B. Matëse e vlerës (njësi llogaritje)**
- **C. Ruajtëse e vlerës (rezervë vlere)**

Format e Parasë

- Historikisht dy forma:
 - a. Paraja mall dhe
 - a. Paraja e dekretuar

Agregatët Monetarë

- Historikisht funksionin e agregatëve monetarë e kanë kryer objekte të ndryshme
- Agregatët monetarë janë tregues të përgjithshëm si aktive financiare (realizojnë shumë qartë funksionin e parasë)
- Ekzistojnë dy mënyra (alternativa) të përcaktimit të agregatëve monetarë:

1. Metoda teorike dhe
2. Metoda empirike

- Sipas *metodës teorike* tipari themelor i parasë është funksioni i saj si mjet këmbimi (kartëmonedha, çeku, çeku i udhëtarëve etj.)
- Sipas *metodës empirike* para quhet ajo që parashikon më mirë lëvizjen e variablave ekonomike që supozohen të shpjegohen me anën e parasë (p.sh. lidhja e ngushtë midis parasë dhe inflacionit apo ciklit të biznesit)

- ***Klasifikimi i Agregatëve Monetarë:***

- ***M1....paratë likuide*** (përdoren direkt dhe pa kufizime për të bërë pagesat)
- ***M2....M1 + aktivet që nuk janë plotësisht likuide*** (depozitat me afat)
- ***M3....M2 + aktive që shumica e njerëzve nuk i shikojnë kurrë*** (depozitet e mëdha të këmbyeshme dhe marrëveshjet e riblerjes, kryesisht korporatat dhe njerëzit e pasur)

- *Agregatët Monetarë sipas Bankës Qendrore amerikane (Rezervat Federale):*

$$M1 = a + b + c + d$$

- a.....Paraja në dorë (monedhat dhe kartëmonedhat në qarkullim)*
- b.....Depozitat në të parë (Llogari të çekueshme në bankat tregtare që nuk sjellin interes)*
- c.....Depozita të tjera të çekueshme (Llogari të çekueshme që sjellin interes)*
- d.....Çeçe udhëtarësh (Çeçe që lëshohen nga institucionet jobankare , p.sh. American Express)*

$$M2 = M1 + e + f + g + h + k + l$$

e.....Marrëveshje ditore të riblerjes (RP ose REPO)

f.....Eurodollarë ditore

g.....Aksione të fondeve të përbashkëta të tregut monetar

h.....Llogaritë e depozitave të tregut monetar

k.....Depozitat e kursimeve

l.....Depozitë të vegjle me afat

$$M3 = M2 + m + n + p$$

m.....Depozita të mëdha me afat

n.....Marrëveshja me afat të riblerjes

p.....Depozita të tjera në Eurodollarë

$$L = M3 + q + r + s + t$$

q.....Obligacione kursimi

r.....Pranime bankare

s.....Letër tregtare

t.....Bono thesari

INSTRUMENTET DHE TREGJET FINANCIARE

- Kalimi i fondeve të huajtshme nga kursimtarët tek përdoruesit realizohet drejtpërdrejt përmes tregjeve financiare
- Por, edhe me ndërmjetës përmes institucioneve financiare

Klasifikimi dhe Agjentët e Tregjeve Financiare

- *Tregu në kuptimin institucional nënkupton organizimin formal (joformal) midis blerësve dhe shitësve që realizon tregtimin e mallërave ose shërbimeve të veçanta*
- Sipas kuptimit “abstrakt” tregu përdoret në modelet dhe teoritë ekonomike (ligjet e ofertës dhe kërkesës)

● *Tregu financiar përfshin lëvizjen direkte të fondeve nga huadhënësi tek huamarrësi*

● Tregjet financiare klasifikohen:

➤ Tregje primare

➤ Tregje sekondare

- ***Tregu primar*** përfshin shitjet e instrumenteve financiarë të emetuar rishtas nga emetuesi tek agjentët e tregut (treg më i thjesht)
- ***Tregu sekondar*** përfshin rishitjen e instrumenteve financiarë ekzistues dhe të emetuar rishtas nga agjentë të tregut financiar dhe zotëruesit e tyre (bursat e zhvilluara botërore; treg më i zhvilluar)

- Sipas afatit të maturimit të instrumentave që shiten në to, tregjet financiare ndahen në:
 - tregje monetare dhe
 - tregje të kapitalit

- *Tregjet monetare* përfshijnë tregtimin e instrumentave me afat maturimi deri në 1 vit
- *Tregjet e kapitalit* përfshijnë tregtimin e instrumentave me afat maturimi mbi 1 vit

Agjentët e Tregut Financiar

- Sipas sjelljes së tyre në treg, Agjentët e TF mund të klasifikohen në:
 1. Spekulatorët
 2. Shmangësit e riskut
 3. Arbitrazhistët
 4. Investitorët

- Këta agjentë dallohen hipotetikisht nga njëri-tjetri
- Në praktikë dallimi i tyre është i vështirë, sepse shume agjentë që përfshihen në një grup plotësojnë kritëret edhe për grupe të tjera
- **Investitorët** – *janë agjentë financiarë që blejnë aktive financiare kryesisht për të ardhurat e tyre që marrin nga zotërimi i tyre*

- **Spekulatorët** – *spekullim është mbajtja e aktiveve për t'i rishitur me një çmim më të lartë se sa ai i blerjes*
- **Shmangësit e riskut** – *agjentë që mbajnë aktive financiare për t'u mbrojtur nga risku i ndryshimit të çmimit*
- **Arbitrazhistët** – *kur aktivet shiten dhe blihen menjëherë me një çmim më të lartë se ai i blerjes, diferenca përfaqëson arbitrazhin, dhe ata që e marrin atë quhen arbitrazhistë*

Tregu Monetar

- *Me TM kuptojmë një grup tregjesh ku tregtohen tituj kredie ose ndryshe instrumenta borxhi që kanë afat të shkurtër maturimi, vlerë nominale të madhe, risk të ulët moskthimi dhe likuiditet të lartë*
- *TM kryen disa funksione të rëndësishme (firmat e mëdha), se siguron rrugë efikase për ekonomizimin e gjëndjes së parasë në dorë*

- Në TM tregtohen tituj kredie afatshkurtër si:

- ❑ letrat tregtare
- ❑ pranimet bankare
- ❑ marrëveshjet e riblerjes
- ❑ eurodollarët
- ❑ bonot e thesarit dhe
- ❑ depozita klienti të këmbyeshme (që janë depozita të mëdha që mund të rishiten në tregun e këmbës)

- ***Bonot e Thesarit*** – janë instrumentet më të tregtueshëm të tregut monetar dhe shprehin formën më të thjeshtë të huamarrjes nga qeveria për të mbuluar deficitin e saj buxhetor
- Qeveria merr hua duke shitur bono thesari me afat maturimi 3 muaj, 6 muaj deri 1 vit, me një skonto nga vlera e tyre nominale

- Shitja e tyre është e njëjtë pothuajse kudo, shiten përmes ankandit me oferta konkurruese dhe jokonkurruese nga BQ
- Përfaqësojnë një instrument me shkallë të lartë likuiditeti, sepse mund të shiten në tregun sekondar të kapitalit me një kosto të ulët transakcionesh dhe risk të ulët çmimi
- Të ardhurat nga këto nuk taksohen

- ***Çertifikatat e Depozitës*** – emetohen nga bankat për të siguruar mjete financiare
- Janë depozita bankare me afat dhe në shuma të mëdha (në SHBA mbi \$ 100.000)
- Nuk mund të tërhiqen para afatit

- ***Letrat Tregtare*** – të ngjashme me bonot e thesarit sepse shiten me skonto dhe në maturim kthehet vlera nominale e tyre
- Emetohen nga kompani të njohura për të plotësuar nevojat e tyre për likuiditete me një kosto relativisht të ulët
- Afati i maturimit deri 270 ditë (shumica deri 1 muaj)

- ***Pranimet Bankare*** – përdoren në tregtinë ndërkombëtare (zakonisht)
- Vula jepet përmes një letër krediti dhe “pranohet”
- ***Eurodollarët*** – janë depozita në dollarë në banka jasht SHBA ose në degët e bankave amerikane në vëndet e tjera

- ***Marrëveshjet e Riblerjes*** – përfaqësojnë shitjet afatshkurtëra, zakonisht ditore, të letrave me vlerë shtetërore në bazë të marrëveshjes për t'i riblerë ato me një çmim më të lartë
- Risku i tyre është i ulët, sepse mbështeten në letra me vlerë shtetërore

- ***Huatë Ndërbankare*** –përfaqësojnë huat afatshkurtëra, zakonisht ditore, që bankat i japin njëra-tjetrës, për të plotësuar nevojat që kanë për likuiditete
- Realizohen përmes depozitave që bankat kanë në Bankën Qendrore, me një normë interesi të fondeve shtetore

Tregu i Kapitalit

- Tregu i Obligacioneve (Tregu i Kapitalit me të ardhura fikse) përfaqëson tregun e titujve të kredisë me afat maturimi mbi 1 vit
- Përfshin: dy lloje obligacionesh të thesarit, obligacionet e korporatës, obligacionet bashkiake, hipotekat, titujt e kredisë të agjencisë federale dhe kreditë

- ***Obligacionet e Thesarit*** – janë tituj kredie të qeverisë me afate maturimi deri në 10 vite dhe nga 10 – 20 vite
- Emetohen me vlerë nominale 1.000 \$ e lartë dhe pagesa e interesit bëhet në formë kuponi dy herë në vit

- ***Obligacionet Bashkiake*** – emetohen nga organet e qeverisë lokale dhe ngjajnë me obligacionet e thesarit, por dallojnë se përjashtohen nga taksat mbi të ardhurat
- Për këto obligacione mund të aplikohen taksat mbi fitimin e kapitalit

- ***Obligacionet e Korporatës*** – janë tituj kredie me afat të gjatë maturimi përmes të cilave firmat private marrin hua nga publiku
- ***Hipotekat*** - janë tituj kredie afatgjata përmes të cilave merren hua për të blerë pasuri të patundshme (ndërtesa, shtëpi etj.) si nga familjet, ashtu edhe firmat

Tregu i Aksioneve

- Përfaqëson shitjen e titujve të pronësisë, që janë pa afat maturimi dhe që quhen aksione
- Kemi dy lloje aksionesh:
 1. Aksione të zakonshme dhe
 2. Aksione të preferuara

INSTITUCIONET FINANCIARE

- Llojlojshmëria e madhe e instrumentave financiarë bazën e ka tek karakteristikat e tyre
- Karakteristikat kryesore lidhen për shkallët e ndryshme të riskut (si për huadhënësin, ashtu edhe huamarrësin)

- Instrumentat e ndryshëm financiarë në përgjithësi dallojnë nga njëri-tjetri:
 - nga preferenca për afate të ndryshme maturimi që kanë huamarrësit dhe huadhënësit lidhur me nevojat e tyre
 - nga shkalla e ndryshme e mundësisë së mosshlyerjes që mvaret si nga lloji i industrisë, ashtu edhe nga niveli i firmës

- nga llojet dhe nivelet e ndryshme të taksimit që zbatohen në instrumenta të ndryshme
- nga shkalla e ndryshme e likuiditetit që lidhet me shkallën e zhvillimit të tregut sekondar
- Ekzistenca e instrumentave të ndryshëm financiarë kushtëzon edhe ekzistencën e institucioneve të ndryshme financiare

I. *Financimi Indirekt nëpërmjet Firmave Financiare*

- Kalimi i fondeve financiare nga huamarrësi tek huadhënësi bëhet përmes:
- *Metoda direkte* (drejtpërdrejt huadhënësi me huamarësin) dhe
- *Metoda indirekte* (përmes ndërmjetësve financiarë, firmave financiare)

- Firmat financiare kushtëzohen nga një varg faktorësh:
 - *Volitshmëria*
 - *Ekonomizimet e shkallës*
 - *Harmonizimi i maturitetit dhe likuiditeti*
 - *Shpërndarja e riskut*

II. Llojet e Ndërmjetësve Financiarë

- Klasifikohen në katër lloje kryesore:

a. Institucionet depozituese (bankat)

b. Kompanitë e investimeve

c. Kompanitë e financimit

d. Ndërmjetësit kontraktualë

A. *Instrumentet Depozituese (Bankat)* janë firma financiare që pranojnë depozita dhe japin hua

- Krijojnë instrumente financiare në dy anët e bilancit (aktiva dhe pasiva)
- Këtu përfshihen: bankat tregtare, bankat e kursimeve dhe bankat (shoqëritë) e kreditit

B. *Kompanitë e Investimit (Fondet e Përbashkëta)* krijojnë instrumenta financiarë kështu:

- në anën e pasivit nëpërmjet grumbullimit të fondeve duke emetuar aksione
- në anën e aktivit blejnë instrumenta financiarë ekzistues (tregun financiar, tregun e obligacioneve dhe tregun derivativ)



- Disa forma kryesore të kompanive investuese:

- ✓ *Trustet*

- ✓ *Fonde të përbashkëta me pasive fikse*

- ✓ *Fonde të përbashkëta me aktive dhe pasive fleksibël*

C. ***Kompanitë e Financimit*** krijojnë instrumenta financiare:

- Në aktiv përmes huave konsumatore dhe tregtare që japin
- Në pasiv përmes emetimit të letrave tregtare ose nëpërmjet emetimit të aksioneve
- Karakteristikë: marrin hua në shuma të mëdha, me interes të ulët, japin hua në shuma të vogla me risk të lartë por me interes të lartë



- Dallohen tre lloje të kompanive të financimit:

- *kompani financimi të shitjeve*

- *kompani financimi të konsumatorit*

- *kompani financimi të biznesit*

D. ***Ndërmjetësit Kontraktualë***, përfaqësojnë institucione financiare që në pasive krijojnë instrumenta financiarë duke lidhur kontrata me huadhënësit

- Dy lloje kryesore:

- a. *Kompanitë e Sigurimit* (sigurimi i jetës e shëndetit dhe sigurimi i pronës), dhe

- b. *Fondet e Pensioneve*

III. Kompanitë e Sigurimit

- Janë sepse ekziston mundësia e ngjarjeve të dëmshme katastrofale
- Krijojnë instrumente financiare në anën e pasivit përmes lidhjes së kontratave (shitja e polisave të sigurimit)
- Në anën e aktivit blejnë instrumenta ekzistues në tregun monetar, obligacioneve, aksioneve, hipotekave...

- Kompanitë e sigurimit ekspozohen ndaj dukurive:
 - *zgjedhja e keqe dhe*
 - *riskut të ndërgjegjes*
- Dy lloje kryesore të kompanive të sigurimit:
 1. *Kompanitë e sigurimit të jetës dhe*
 2. *Kompanitë e sigurimit të pronës*

- Parimet më të njohura të menaxhimit në kompanitë e sigurimeve:

- *Analiza e imët e informacionit*
- *Prime sigurimi të mbështetura në nivelin e riskut*
- *Klauzolat kufizuese*
- *Parandalimi i mashtrimit*
- *Anulim i siguracionit*
- *Zbritjet nga shpërblimi*
- *Bashkësigurimi*
- *Kufizime në madhësinë e shpërblimit nga sigurimi*

FIRMAT BANKARE

- Vend të rëndësishëm në kuadrin e ndërmjetësve financiarë që realizojnë financimin indirekt
- Realizojnë pjesën kryesore të transaksioneve të financimit indirekt

I. Bilanci dhe Elementet Bazë të Veprimtarisë së një Banke

- Bilanci përbëhet nga Aktivi dhe Pasivi
- Karakteristikë e bilanceve: barazia e dy anëve

$$*Aktivet = Pasivet + Kapitali*$$

Aktivet

Aktivet Plotësisht Likuide ose Rezervat Parësore

AKTIVI

I. Aktive plotësisht likuide (Rezervat Parësore)

A. Arka

1. Arka në monedhë kombëtare
2. Arka në monedhë të huaj

B. Depozitat në Bankën Qendrore

II. Aktive Likuide (Rezervat dytësore)

A. Letra me vlerë shtetërore

1. Të Qeverisë
2. Të organeve lokale

B. Kredi dhënë bankave të tjera

III. Aktive të tjera

A. Depozitat në banka të tjera

B. Interesa për t'u arkëtuar

IV. Kredi (Huadhënie)

- A. Biznesi
- B. Hipotekash
- C. Personale
- D. Bujqësore

V. Aktive fikse

- A. Ndërtesa
- B. Makineri e Pajisje
- C. Të tjera

PASIVI

I. Depozitat

A. Llogaritë në të parë (të çekueshme)

1. Llogari pa interes
 2. Llogari me interes
- ##### B. Llogari depozitash (të paçekueshme)

1. Depozita Kursimi

2. Depozita Kursimi me afat

3. Depozita të Tregut Monetar

II. Borxhet (Huamarrjet)

A. Huamarrjet prej Bankës Qendrore

B. Huamarrjet prej bankave të tjera

C. Eurodollarët (Euros\$)

D. Borxhe afatgjatë

III. Pasive të tjera

A. Taksa të papaguara

B. Interesa për t'u paguar

C. Rezerva për humbje nga kreditë

IV. Kapitali

A. Kapitali i paguar

B. Fitimet e mbetura

C. Të tjera

II. Drejtimi i Likuiditetit dhe i Aktiveve të Bankës

- *Me drejtim të likuiditetit kuptojmë aftësinë e bankës për të plotësuar kërkesat e depozituesve në çdo kohë që dëshirojnë të tërheqin depozitat e tyre ose të bëjnë pagesa nëpërmjet lëshimit të çeqeve*
- Ky qëllim ndeshet me interesat bankare
- Banka mbështetet në parimin empirik: plotësim i nevojave mesatare për tërheqje depozitash

- Banka mban një pjesë të aktiveve në formën e rezervave parësore (të detyrueshme dhe të tepërta)
- Nëse bankës nuk i mjaftojnë këto rezerva për të përballuar tërheqjet, ajo ka këto mundësi:
 1. *Pakësimi i kredive*
 2. *Shitja e kredive ekzistuese*
 3. *Banka mban aktive likuide në formën e rezervave dytësore*
 4. *Banka siguron mjete financiare përmes huave më skonto*
 5. *Huatë ndërbankare*

➤ *Drejtimi i Aktiveve të Bankës*

- *Kuptojmë përcaktimin e një portofoli aktivesh që siguron një fitim maksimal me një risk minimal*
- Qëllimi: maksimizimi i fitimit

- *Teknikat kryesore:*

1. Sigurimi ose gjetja e huamarrësve të përshtatshëm (që paguajnë norma më të larta interesi me risk të ulët mospagimi)
2. Një rezervë e çojnë në blerjen e letrave me vlerë (më shumë shtetërore)
3. Bankat diversifikojnë portofolin e aktiveve për të shmangur riskun e moskthimit dhe likuiditetit
4. Drejtojnë likuiditetin e aktiveve duke plotësuar rezervat e detyrueshme me një kosto sa më të ulët

III. Parimet e Drejtimit të Huave

- Bankat japin hua për fitime
- Dy koncepte:
 1. *Zgjedhja e keqe*
 2. *Risku i ndërgjegjes*

- *Analiza e imët e informacionit dhe mbikëqyrja*
- *Marrëdhëniet afatgjata me klientin dhe linjat e kreditit*
- *Kolaterali dhe bilanci i kompensimit*
- *Racionimi i kreditit*

RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA NË SISTEMIN BANKAR

- Sistemi bankar ndër sistemet më të mbikëqyrur
 - 1. Asimetria e informacionit dhe rregullimi bankar*
 - Lidhet me faktin se dy palë në një kontratë financiare nuk kanë të njëjtin informacion
 - Paraqitet problemi i zgjedhjes së keqe dhe riskut të ndërgjegjes

- Modeli i rregullimit bankar – bazë për konceptin e asimetrisë
- 7 forma bazë të rregullimit bankar:
 1. Garancia shtetërore
 2. Kufizime lidhur me aktivet dhe kapitalin e bankës
 3. Mbikëqyrja bankare
 4. Vlerësimi i riskut
 5. Transparenca
 6. Mbrojtja e konsumatorëve
 7. Kufizimi i konkurrencës

➤ *Garancia Shtetërore : Sigurimi i Depozitave dhe ASD (Agjencioni për Sigurimin e Depozitave)*

- Përmes grumbullimit të depozitave dhe huadhënies bankat duhet të shmangin fenomenin “Kalorësi i lirë”

- Problemi i asimetrisë së informacionit çon në keqfunksionimin e sistemit bankar për dy arsye:
 1. Nëse banka falimenton depozituesit do të prisnin t'i rimarrin shumat e tyre nga procesi i likuidimit
 2. Kur depozituesit nuk kanë informacion për aktivet e bankës lind më lehtë paniku bankar

- Skemat e sigurimit të depozitave përdorin dy metoda për të administruar falimentimin bankar:
 1. Metoda e shlyerjes
 1. Metoda e blerjes dhe shkrierjes

➤ *Kufizime lidhur me Aktivet dhe Kapitalin e Bankës*

- Risku i ndërgjegjes në kushtet e garancisë shtetërore inkurajon bankat për më shumë risk
- Rregullatorët e bankave minimizojnë riskun e ndërgjegjes
- Kufizojnë bankat në aktive dhe kapital minimal të bankës për fillim dhe vazhdim të aktivitetit bankar

- *Mbikëqyrja bankare (e kujdesshme)*
 - *Kontrollorët përcaktojnë për bankën klasifikimin GAMEL që ka të bëjë me:*
 - ✓ *mjaftueshmërinë e kapitalit*
 - ✓ *cilësinë e aktiveve*
 - ✓ *menaxhimin e bankës*
 - ✓ *të ardhurat*
 - ✓ *likuiditetin*
 - ✓ *ndjeshmërinë ndaj riskut të vogël*

➤ *Vlerësimi i Riskut*

- Kontrolli tradicional nuk është i mjaftueshëm për vlerësimin e riskut bankar
- Sistemi modern i komplikuar, poashtu vlerësimi për riskun bankar

➤ *Transparenca*

- Fenomeni “Kalorësi i lirë” krijon nevojën për transparencë
- Transparenca përmes pasqyrave financiare kontabël në mënyrë publike

➤ *Kufizimi i Konkurrencës*

- Rritja e konkurrencës rrit njëherit edhe riskun e ndërgjegjes që ndeshin bankat
- Rënia e fitimeve pasojë e konkurrencës
- Tendencë për më shumë risk për ruajtjen e fitimit të mëparshëm të bankës
- Autoriteti mbikëqyrës ndërhyr për të minimizuar nivelin e riskut në sistemin bankar

➤ *E-Banking, sfida e re për Mbikëqyrjen Bankare*

- Lindja dhe zgjerimi i E-Banking ngritje diskutimesh për autoritetet mbikëqyrëse
- Shqetëson fakti i humbjes së parave
- Mundësi e futjes në llogari të klientit
- Klientët nuk janë në dijeni për nivelin e sigurisë që kanë kompjuterët
- Autoritetet mbikëqyrëse më shumë në përcjellje

➤ *Rregullimi i Banking-ut Ndërkombëtar*

- Asimetria e informacionit, problem në glob
- Marrëveshja e Bazelit – standart bankar ndërkombëtar
- Rregullatorët e sistemit bankar kontrollojnë veprimtaritë e bankave në mbarë botën

➤ **Krizat kryesore bankare në botë**

1. Kriza në Skandinavi – liberalizimi financiar në vitet '80, kostoja humbje 4 – 11% e GDP
2. Kriza në Amerikën Latine
3. Kriza në Evropën Lindore
4. Kriza bankare në Japoni
5. Kriza në Azinë Lindore
6. Kriza “ëall – Street” – SHBA, Angli etj. (2009 – 2010)

Nr.	Periudha	Vendi	Kostoja e rritjes si % e GDP
1.	1980 - 1982	Argjentina	55
2.	1997 - 2002	Indonezia	50
3.	1981 - 1983	Kili	41
4.	1997 - 2002	Tajlanda	33
5.	1997 - 2002	Korea Jugore	27
6.	1997 - 2002	Malejzia	16
7.	1994 – 1997	Venezuela	22
8.	1995	Meksika	19
9.	1990 - 2002	Japonia	20
10.	1989 - 1991	Çekia	12
11.	1991 - 1994	Finlanda	11
12.	1991 - 1995	Hungaria	10
13.	1994 - 1996	Brazili	13
14.	1987 - 1993	Norvegjia	8
15.	1998	Rusia	5 – 7
16.	1991 - 1994	Suedia	4

Kriza financiare në botë

- Sipas Çarls P. Kindëllbergerit, krizat financiare janë si gratë e bukura: "Është e vështirë t'i përshkruash, por cilido i dallon menjëherë"
- Midis 1945 dhe 1973 ka pasur vetëm kriza financiare të veçuara dobët
- 28 vjet qëndrueshmëri - kjo është unike dhe me gjasa do të mbetet unike

- Cilat ishin arsyet?
- Natyrisht, lulëzimi ekonomik i Evropës mbi gjërmadhat e Luftës së Dytë Botërore
- “Plani Marshall”, ndarja e botës, gara e sistemeve, ndodhën njëkohësisht me shtytje të fuqishme rritjeje ekonomike
- Por, po kaq i rëndësishëm “Sistemi Bretton Woods”

- Marrëveshja “Bretton Woods” ekzistoi deri më 14 Gusht 1973
- Atë ditë, presidenti amerikan Riçard Nikson e prishij në mënyrë të njëanshme sistemin monetar të kohës së pasluftës
- Luftën e Vietnamit SHBA e kishin financuar me anë të kredive
- Si rezultat u rrit shumë sasia e dollarit në qarkullim
- Kishte rënë këmbana e epokës së re
- Vite më vonë ajo mori edhe emrin: **globalizim**

- Kapitali rridhte drejt Botës së Re dhe drejt kolonive
- Ndërtimi i hekurudhave ofroi hapësirë të mjaftueshme për depozita shpekuluese
- Industria elektrike dhe kimike konkurronin në tregun botëror për hegjemoni
- Faza e dytë e qarkullimit të liberalizuar të kapitalit filloi pas Luftës së Parë Botërore në vitet '20 (shek kaluar)

- Kredi afatshkurtëra nga SHBA mbulonin nevojën për financim në Evropën e pasluftës
- Franca dhe Britania e Madhe e kishin financuar luftën kryesisht me kredi nga SHBA dhe donin t'i paguanin huatë me reparacione nga Gjermania
- Gjermania nga ana tjetër e kishte financuar luftën me obligacione të shtetasve të vet dhe me emetim të ri kartëmonedhash
- Pas të “Premtës së Zezë” në bursën e Nju-Jorkut investuesit amerikanë i tërhoqën paratë brenda natës nga Gjermania

- Pasojat janë të njohura
- Bota pas Luftës së Dytë Botërore kishte rregull për tri dekada
- Me prishjen e sistemit “Bretton Woods” (1973) nisi vala e tretë e qarkullimit të lirë të kapitalit dhe keqësoi dramatikisht krizën e borxheve në vendet e Botës së Tretë
- Vala deri tani e fundit nisi njëkohësisht me kollapsin e bllokut socialist
- Parakushtet për tranzicionin politik dhe ekonomik në ELQ

- Sekuenca të filmit “Titanic”, ku edhe pse është e qartë se anija gjigante do mbytet, procesi duket se zgjat një jetë të tërë
- Mjerimi rrjedh më shumë nga fakti se nuk dihet se kur kjo panoramë dhimbjeje do marrë fund
- Kriza financiare (2009) më e madhe në SHBA, që pas Depresionit të Madh ka shkatërruar institucionet e shquara financiare globale

- Kriza ka lënë gjurmë të madhe në thesarin amerikan, ka destabilizuar sistemin botëror financiar
- “Lehman Brothers Holdings Inc.” një ndër bankat më të mëdha të investimeve në SHBA u zhyt në krizat e hipotekave duke krijuar kështu falimentimin më të madh në histori
- Firma 158-vjeçare e cila u ka mbijetuar falimentimeve hekurudhore të vitit 1800, Depresionit të Madh të vitit 1930 dhe rënies së Menaxhimit të Kapitalit Afatgjatë falimentoi më 15 09 2009

- Rënia e “Lehman”, e cila kishte më shumë se 613 miliardë dollarë borxh, i bën të duken më të vogla paaftësitë për të paguar obligimet
- Kompania humbi 94 për qind të vlerës së saj të tregut
- Bankat rivale kanë mbajtur një sesion për organizimin e një rrjeti kontakti për transaksionet e të ardhurave me “Lehman” për të reduktuar pasigurinë në treg

- Kompania “**World Com**” kishte asete para falimentimit 104 mld US\$
- Kompania **Enron Corp.** kishte asete para falimentimit 66 mld US\$
- Kompania **Conseco Inc** kishte asete para falimentimit 61 mld US\$

- **Çfarë mendojnë ekspertët për krizën financiare botërore?**
- Humbje miliardëshe bëri të ditur banka e investimeve “Merrill Lynch”, pas analizave të bëra
- Ajo nuk është e vetme që analizoi situatata
- Shefat e bankave u përballen me vështirësi të mëdha
- Më shumë se 18 mld US\$ të humbur, dividendët u shkurtuan 41%, dhe 4 200 vende pune u humbën
- Lajmi ra si bombë në Wall Street, kursi i aksioneve të Wall Street ra brenda disa minutave

- Kryetari i Bashkisë së Clevelend deklaroi: “nuk ndjej aspak keqardhje për menagjerët e bankave, që humbën punën për shkak të krizës së hipotekave”
- Cleveland është një qytet ku shumë pronarë shtëpish janë shkatërruar nga hipotekat joserioze
- "Unë shoh çdo ditë njerëz jeta e të cilëve është shkatërruar nga hipotekat mashtruese. Lagje të tëra të lëna pas dore, sepse njerëzit duhet të dilnin nga shtëpitë e tyre. Nëqoftëse tani top menaxherët humbasin punën nga kriza e hipotekave, atëherë ky është problemi i tyre. Ata i kanë patur sytë në ballë dhe tani duhe të mbajnë mbi supe pasojat" – deklaroi ai

- Cleveland ngriti padi kundër 21 instituteve financiare që janë përfshirë në shpekullimet me hipoteka të lira, ndër ta edhe kundër Deutsches Bundes Bank (Banka Qendrore Gjermane)
- Kriza e Wall Street rrezikoi shoqërinë amerikane (James Ellmann)
- Charles Schumer njëri nga senatorët më më influencë në SHBA i bëri apel presidentit amerikan që të heq dorë nga politika e tij fiskale që favorizon vetëm të pasurit
- "Ka ardhur më në fund koha që Bushi me politikën e tij fiskale t'u mundosojë financiarisht jetesën të gjitha familjeve amerikane" – tha Schumer

● **Kriza financiare dhe Kosova**

- BQK nuk ishte brengosur për krizat në tregjet financiare nëpër botë, duke u shprehur se bankat dhe kompanitë e sigurimeve në Kosovë nuk janë të ekspozuara direkt me ato tregje financiare globale
- Zhvillimet në SHBA u reflektuan më rënien e vlerës së aksioneve në bursat në mbarë botën dhe me drojën se çfarë do të ndodhë më tutje
- Nuk kishte ndonjë impakt direkt për shkak se bankat komerciale të Kosovës nuk kanë ekspozime shumë të mëdha në tregjet financiare të Evropës dhe globit

- Në bazë të analizave del se bankat komerciale për shkak të besueshmërisë që kanë në tregun e Kosovës kanë zvogëluar përqindjen e plasmanëve që e bëjnë jashtë dhe ato mjete janë duke investuar në ekonominë e Kosovës
- Pra, ka një rritje të kredive rreth 40 % vit për vit, prandaj në këtë sens nuk ka ndonjë efekt madhor në sektorin financiar të Kosovës

- Kostoja e fondeve ku bankat komerciale i marrin nga tregjet e Evropës është rritë për shkak të krizës financiare
- Prandaj në mënyrë indirekte kjo ka ndikuar që ato të kenë shpenzime shumë më të mëdha në marrjen e fondeve, që i plasojnë në ekonominë e Kosovës

- **Konkluzion:** Kosova nuk mund të përjetojë ndonjë tronditje të madhe, mund të ketë ndonjë tronditje shpekulative nga sistemi bankar i Kosovës, i cili është lënë më tepër në stih të kohës, në mbrojtje të interesave të klaneve të caktuara, se sa që dominon një profesionalizëm i vërtetë dhe për këtë arsye vet fakti që ndodh kjo që po ndodh do të jetë një arsyetim bankar pse ata i kanë kamatat e larta

- Ndryshe, përpjekjet për të dalë nga kjo krizë po vazhdojnë përherë në botë
- Presidenti Bush kishte kërkuar nga Kongresi 700 mld US\$ për të ashtuquajturin “Planin e Ri të Shpëtimit”
- Sipas planit i cili u cilësua si më i madhi për shpëtime nga falimentimi në historinë amerikane, qeveria duhej të blejë kreditë që nuk mund të paguhen nga institucionet financiare amerikane

- Bush tha se programi rrezikon shumë para të taksapaguesve, por shtoi se kjo do të kushtonte më pak se mosndërhyrja e qeverisë
- Përpjekje e përbashkët për dalje nga kriza financiare e “Grupit 7” (pa Rusinë)

KRIJIMI I PARASË DHE OFERTA MONETARE

- “*Paraja lind para*” proverb anglez

I. Koncepti i Bazës Monetare dhe Përcaktuesit e saj

- Agregatët monetarë përbëhen nga komponentë të shumtë
- Nga aspekti ekonomik disa komponentë të agregatëve monetarë quhen *para e fuqishme* (baza monetare)

- *Me bazë monetare kuptojmë sasinë e parasë në dorë që mbahet nga publiku dhe rezervat totale të bankave*

$$\mathbf{B = C + R_t}$$

B.....Baza Monetare

C.....Paraja në dorë që mblidhet nga publiku

R_t.....Rezerva totale bankare

$$R_t = A + DBQ$$

Rt.....nga pikëpamja e formës së mbajtjes

A.....arka

DBQ.....depozita në bankën qendrore


$$R_t = R_d + R_e$$

Rt.....nga pikëpamja e mënyrës së krijimit

Rd.....rezervat e detyrueshme

Re.....rezervat e tepërta

Skema: Rritja e bazës monetare duke blerë letra me vlerë shtetore



II. Procesi i Krijimit të Parasë dhe Multiplikatori i Ofertës Monetare

- Procesi analizohet përmes mekanizmit të shumëfishimit të depozitave që nxitet nga rritja e rezervave të bankës
- *Baza e shumëfishimit të depozitave qëndron në faktin se banka mund t'i mbulojë depozitat duke mbajtur vetëm një pjesë të tyre si rezervë dhe pjesën tjetër ta jap hua*

- Mundësia e bankës për dhënie të huas, pa cenuar detyrimet që ka ndaj depozituesve, krijon mundësinë e rritjes së depozitave, por edhe ofertën e parasë

TEORITË E KËRKESËS PËR PARA

- Kërkesa për para pasqyron f-net e parasë si mjet këmbimi dhe ruajtëse e vlerës
- Andaj, edhe teoritë e kërkesës për para ndahen në dy grupe:
 1. *Teoritë e kërkesës së transakcioneve, dhe*
 2. *Teoritë e kërkesës së aktiveve*

I. **Konceptet Bazë të Kërkesës për Para**

➤ ***Elasticiteti i të Ardhurave për Para, Ey***

- Të ardhurat përfaqësojnë një nga faktorët themelorë që ndikojnë në Kërkesën për Para
- Rritja e të ardhurave rrit kërkesën për mallëra e shërbime
- Prandaj, rritet si rrjedhojë edhe kërkesa për para për realizim të transaksioneve adekuate

➤ *Elasticiteti i Normës së Interesit të Kërkesës për Para, Ei*

- Shumë teori predikojnë lidhjen negative të Kërkesës për Para me Normat e Interesit
- Nëse paraja nuk sjell interes, mbajtja e saj shkakton një kosto = me interesin që sjell përdorimi alternativ (p.sh. Investimi në letrat me vlerë)

➤ ***Faktorët e Sistemit të Pagesave dhe Kërkesa për Para***

- Në kërkesën për Para ndikojnë edhe Faktorët e Sistemit të Pagesave
- Lloji i parasë që zgjedhin njerëzit për të bërë pagesat (para në dorë, çek etj.)
- Frekuenca kohore përbën një faktor tjetër

II. Teoritë e Kërkesës për Para që mbështeten në Funkcionin si Mjet Këmbimi

- Teoria përqendrohet në tre variabla kryesorë që ndikojnë në Kërkesën për Para:
 - ✓ *Vëllimi i transaksioneve (ose i të ardhurave)*
 - ✓ *Faktorët e ndryshëm të sistemit të pagesave, dhe*
 - ✓ *Normat e interesit*

➤ ***Teoria Sasiore Klasike e Kërkesës për Para (CQ)***

- Është teoria më e vjetër
- Përfaqësues Irving Fisher (USA), libri *Fuqia blerëse e parasë* (1911)
- Teoria: *Shpejtësia e të ardhurave të parasë megjithse ndikohet nga një varg faktorësh, është konstante në periudhën afatshkurtër dhe niveli i produktit është i dhënë në periudhën afatshkurtër, sepse ekonomia është në punëzënieën e plotë*

- Teoria supozon: *njerëzit i marrin të ardhurat në para dhe nuk kursejnë fare, të ardhurat merren periodikisht në masë të njëjtë, norma ditore e konsumit është e njëtrajtshme gjatë gjithë vitit dhe stoku monetar përfaqësohet nga M1*

➤ ***Varianti i zgjeruar i Teorisë Sasiore Klasike***

- Fisheri analizoi faktorët (frekuenca, dendësia e popullsisë, shërbimi postar)
- Tregon: rritja e tyre ul kërkesën për para
- Teoria zgjerohet më tej
- Aktualisht veprojnë faktorët:
 - ✓ *Sinkronizimi i marrjes së të ardhurave me shpenzimin e tyre, dhe*
 - ✓ *Mbajtja e parasë për qëllime mbrojtëse e kursimi jasht sistemit bankar*

- *Sinkronizimi* përfaqëson vendosjen e një korrespondence kohore midis marrjes së të ardhurave dhe shpenzimit të tyre për konsum
- Model sinkronizimi: *Karta e Kreditit*
- *Mbajtja e parasë për motive mbrojtëse*

➤ *Teoria Baumol – Tobin e Kërkesës për Para*

- Karakteristikë e përbashkët me Teorinë Sasiore: *njerëzit mbajnë paranë për të realizuar transaksionet*
- Dallimi: *njerëzit mund të investojnë përkohësisht paratë që mbajnë*

- *Vendimet e menaxhimit të parasë në dorë*
- Zgjedhja: të mbahet në dorë, apo investuar
- Vendimi i menaxhimit të parasë mvaret nga 3 faktorë:
 - ✓ nga paratë që investohen merret interes, ndërsa nga paratë e llogarisë merret interes i ulët, ose nuk merret fare
 - ✓ për realizimin e konsumit shërbejnë paratë në llogaritë e transaksioneve
 - ✓ Transferimi i fondeve nga llogaria e investimeve në llogarinë e transaksioneve kërkon kohë, energji dhe shpenzime monetare

III. Teoritë e Kërkesës për Para që mbështeten në Funkcionin e Parasë si Ruajtëse e Vlerës

- Kryesore teoritë e:
 - ✓ Keynes
 - ✓ Tobin dhe
 - ✓ Friedman

➤ ***Teoria Keynesianiste e preferencës për likuiditete***

- Mbështetet në 3 motive të mbajtjes së parasë:
 - ✓ Motivi i transakcioneve
 - ✓ Motivi mbrojtës dhe
 - ✓ Motivi shpekulativ

➤ ***Teoria e Tobin-it e preferencës për likuiditete***

- Kryesisht mbështetet në Keynes-in
- Tobin: investitorët e shpërndajnë pasurinë në aktive të ndryshme:
 - ✓ Paraja
 - ✓ Obligacionet
 - ✓ Aksionet

➤ ***Teoria sasiore moderne e parasë e Friedman-it***

- *Teoria e të ardhurave permanente e kërkesës për para* thekson se njerëzit mbështeten më tepër në periudhat afatgjate (pasuria), se sa në periudhat afatshkurtëra (të ardhurat korente)

KËRKESA DHE OFERTA E PARASË NË TREGUN MONETAR

- Objektivat:
 - *Ekilibri në tregun monetar*
 - *Faktorët që ndikojnë në ndryshimin e ekuilibrit*
 - *Mënyra e ndikimit të faktorëve*
 - *Përcaktimi i normave të interesit dhe nivelit të të ardhurave në ekuilibrin monetar*

I. Ekuacionet dhe Kurbat e Kërkesës e Ofertës për Para

- Kërkesa për Para përcaktohet nga tre variabla kryesore:
- ✓ Madhësia në vlerë e transaksioneve që varet nga të ardhurat nominalë (PY)
- ✓ Kosto oportune e parasë ose norma e interesit të tregut (i)
- ✓ Faktorët e sistemit të pagesave (S)

$$M_d = M_d (I, PY, S)$$

- **Md** = Kërkesa për para
- **i** = kosto oportune e parasë (*përfaqëson diferencën midis normave të interesit të letrave me vlerë dhe normave të interesit të parasë*)
- **PY** = të ardhurat nacionale
- **S** = faktorët e sistemit të pagesave

- Supozim i të gjitha teorive është se Kërkesa për Para lidhet:

- *negativisht me normën e interesit*
- *pozitivisht me nivelin e të ardhurave nominale*
- *pozitivisht ose negativisht me faktorët e sistemit të pagesave*

- *Oferta e Parasë*, përcaktohet përmes këtij procesi:
 - BQ përcakton madhësinë e bazës monetare duke blerë ose shitur letra me vlerë
 - Publiku përcakton madhësinë e parasë në dorë që mban, duke depozituar pjesën tjetër në bankë ku llogaritet si rezervë bankare
 - Depozitat e transaksioneve përcaktohen nga procesi i ekspansionit të depozitave

II. Ekuilibri në Tregun Monetar

- Lidhet ngusht me ekuilibrin e tregut të fondeve të huajtshme dhe të tregut të mallërave
- Kusht i ekuilibrit në tregun monetar barazimi i kërkesës me ofertën e parasë

KURSET NDËRKOMBËTARE TË KËMBIMIT

- Ekonomia globale përfshin ekonomitë e vendeve të ndryshme, të hapura
- Ekonomia globale në mallëra dhe shërbime
- Vendet e ndryshme – monedhat e veta
- Unionet një valutë

- Valutat këmbehen midis vete, përbejnë Tregun Valutor
- *Çmimi me të cilin këmbehen valutat ndërmjet vete quhet Kursi i Këmbimit të Valutës*
- *Kursi i Këmbimit përfaqeson çmimin e valutës së një vendi i shprehur në valutën e një vendi tjetër (p.sh. 1 \$ = 99,76 Lekë)*

- *Vlerësimi* (kur monedha vendase në raport me monedhën e huaj rritet)
- *Zhvlerësimi*, e kundërta

Përcaktimi i Kurseve të Këmbimit

- Kurset e këmbimit përcaktohen nga Kërkesa dhe Oferta
- Kërkesa për valutë përcaktohet nga:
 - *Eksportet*
 - *Hyrjet e kapitalit*
 - *Transakcionet (marrja hua e valutave nga jasht)*
 - *Shitje e aktiveve jasht*

- Varësisht nga llojet e ndryshme të transaksioneve që realizohen, tregjet valutore klasifikohen:

- **Tregu valutor korent**

- **Tregu valutor me afat** (*Tregu valutor me afat të pastandardizuar, të standartizuar dhe alternativ – opcional*)

Terminologjia e Kurseve të Këmbimit

- Kurse këmbimi luhatëse
- Kurse fikse këmbimi

Analiza Afatgjatë e Kurseve të Këmbimit

- Përcaktimet e kurseve të këmbimit në tregun valutor ndikohen në periudha afatgjata dhe afatshkurtëra
- *Ligji i një Çmimi* (dy vënde prodhojnë një mall të njëjtë dhe më një mënyrë të njëjtë, atëherë çmimi i mallit duhet të jetë i njëjt në dy vendet)

- *Teoria e Paritetit të Fuqisë Blerëse*, një nga më të njohurat
- Teoria: kurset e këmbimit midis dy valutave duhet të përshtaten asisoj që të pasqyrojnë ndryshimet në nivelin e çmimeve të dy vëndeve përkatëse

- Teoria konkludon: *nëse niveli i çmimeve të një vendi rritet në raport me nivelin e çmimeve të një vendi tjetër, atëherë valuta e tij duhet të zhvlerësohet*
- Inflacioni
- Produktiviteti
- Shijet dhe preferencat për mallëra vendase në raport me ato të huaja
- Tarifat dhe Kuotat
- Kufizimet e lëvizjes së kapitalit financiar

Evolucion i Sistemit Financiar Ndërkombëtar

- Para Luftës së I-rë Botërore, ekonomia botërore mbështetej në **standartin e arit**, ku valuta vendase këmbehej me ar
- Kurset fikse të këmbimit me ari kishin përparësinë e nxitjes së tregtisë botërore, ngase eliminohet pasiguria që vjen nga kurset luhatëse të këmbimit

- **Sistemi Bretton Woods** (1944, Bretton Woods – New Hampshire), themelimi i një sistemi financiar ndërkombëtar me qëllim fuqizimin e ekonomisë globale pas Luftës II-të Botërore, FMN e BB
- **Sfida e Euros ndaj Dollarit** (1999 Euro valutë e përbashkët e vendeve të UE)